



Viti i XIV -të i Botimit, Nr.1,
Qershor 2022

MODERNIZIMI URBAN ME TIPARE SOCIALISTE I QYTETEVE TRADICIONALE SHQIPTARE

Agron Mesi*

*Instituti i Antropologjisë Kulturore dhe Studimeve të Artit, Akademia e Studimeve Albanologjike, Tiranë

Albanian University, Fakulteti i Shkencave të Aplikuara dhe Ekonomike,

Departamenti i Art Dizajnit, Tiranë.

Adresë kontakti: mesiagron@gmail.com

Përmbledhje

Në këtë tekst, vëmendje studimore do të marrë periudha e modernizimit socialist të Shqipërisë, dhe pikërisht një nga dukuritë më përfaqësuese të saj, siç qe ajo e trajtimit të trashëgimisë urbane të së kaluarës dhe e planifikimit për rimodelimin urban të saj me tipare socialiste.

Në tërësinë e tij, modernizimi urban i Shqipërisë, në periudhën pas Luftës së Dytë, u konceptua dhe u trajtuar në vazhden e tij dyzetepesë vjeçare si një projekt politik me kumte të mirëfillta ideologjike. Filli lidhës i të gjitha dukurive urbane të periudhës së socializmit do të ishte *moderniteti* si vizion dhe *modernizimi* si mision, si dhe përpjekja për të mundësuar materializim e tyre mbi territorin dhe shoqërinë shqiptare me ndërmjetësinë e *ideologjisë komuniste* dhe të sistemit politik të *socializmit shtetëror*. Qasja ideologjike çoi në centralizimin nga ana e shtetit të të gjitha koncepteve, politikave, projekteve e nismave konkrete për trajtimit e trashëgimisë urbane të qyteteve tradicionale dhe rimodelimin urban të tyre me tendencë modernizimin, por njëkohësisht duke shkëputur lidhjet e tyre me të kaluarën.

Fjalët çelës: *modernizim, urbanizim, qytet tradicional, rimodelim urban, socializëm shtetëror, centralizim.*

URBAN MODERNIZATION WITH SOCIALIST FEATURES OF TRADITIONAL ALBANIAN CITIES

Abstract

The period of socialist modernization of Albania will be the focus of this article, and precisely one of its most representative occurrences, such as treatment of urban inheritance of the past and planning for its urban remodeling with socialist features. In its entirety, the urban modernization of Albania, in the period after the Second World War, was conceived and treated in its forty-fifth year continuity as a political propaganda which consists of ideological messages. The connecting thread of all urban occurrences of the socialist period would be modernity as a vision and modernization as a mission, as well as the attempt to enable their materialization in the Albanian territory and society with the mediation of the communist ideology and political system of state socialism. This ideological approach led to the centralization by the state of all concrete concepts, policies, projects and initiatives for the treatment of urban heritage of traditional cities and their urban remodeling, their modernization, but from which it severed ties with the past.

Key words: *modernization, urbanization, traditional city, urban remodeling, state socialism, centralization*

1. Hyrje historike dhe vështrim literature mbi modernizimin urban

Politikat e modernizimit urban

Mënyrat, qëllimet dhe format se si ndërtohen dhe ç'ndërtohen qytetet janë tregues direkt të koncepteve sesi kanë funksionuar dhe funksionojnë shoqëri të caktuara në kohë të caktuara.

Sisteme të ndryshme pushtetesh prodhojnë lloje të ndryshme organizimesh urbane dhe lloje të ndryshme arkitekture shtetërore, publike e banimi. Studiuesi Juha Varto në veprën e tij *“Arti dhe mjeshtëria e Bukurisë”* thekson se: *“Secila dinasti përpaket të lërë pas një gjurmë të qëndrueshme të vetes, duke e bërë monumentale arkitekturën, dhe kjo [materie urbane] nënkupton në tërësinë e vet një qytet. Sapo ndërtohet, qyteti shndërrohet në sinonim të vetë pushtetit, duke përcaktuar gjithashtu zhvillimin e ardhshëm të mbretërimit të tij (së brendshmi dhe së jashtmi). Së brendshmi, do të thotë që qytetari duhet të bëjë të dukshme arsyen përse ekziston dinastia. Për pasojë, çdo dinasti krijon arkitekturën e saj, planin e saj të qytetit dhe monumentet përfaqësues të tij. Ndërtesat lidhen me legjitimitetin e brendshëm dhe të jashtëm të pushtetit. Pra kështu bëhet e kuptueshme përse kur është dashur të shkatërrohet një dinasti, vendimtare ka qënë shkatërrimi i qytetit të saj”*. [1]

Në Evropë, revolucioni modernizues në lidhje me rikonceptimin e qytetit dhe të arkitekturës së tij, historikisht filloi shumë më vonë se zhvillimet përmbysëse dhe njëkohësisht risuese, që ndodhën përgjatë shekullit të XIX në fushat e ekonomisë, politikës, kulturës dhe arteve në përgjithësi. Megjithatë në periudhën e revolucionit industrial u ndërtua shumë, trajtimi urban i qytetit dhe vetë stili arkitekturor i tij, rezistuan mjaft gjatë në lidhje me reflektimin e koncepteve të reja thellësisht moderne.

Vetëm në fundin e shekullit të XIX dhe në fillimet e atij të XX, revolucioni modernist u shtri gjerësisht edhe në fushën e urbanistikës dhe të arkitekturës së qytetit. Fillimisht nocioni i ri u shfaq si kontestim i

anës tejet zbukurimore që mbizotëronte deri më atëherë në arkitekturën urbane europiane. Në thelb u vu në diskutim vetë koncepti i zbukurimit, e aq më tepër ashtu siç praktikohet ai në *la belle époque*, antifunksional, parazit, thjeshtë zbukurim për hir të zbukurimit. Zbukurimi dhe ornamentika në arkitekturë, mjedise dhe objekte, deri më atëherë përfaqësonin dhe simbolizonin statusin klasor të investitorit apo poseduesit, dukjen dhe shfaqjen e rangut social të tij. Në kundërti të këtij koncepti, për modernistët, dekorimi dhe zbukurimi u panë si *moralisht të papranueshme, intelektualisht të pambrojtshme dhe estetikisht zvetënuese*. [2] Ndaj kësaj shijeje “*të keqe*” dhe këtij “*mashtrimi*”, modernizmi kundërvuri estetikën e tij racionaliste, ideologjinë utopike dhe etikën protestante të punës dhe jetesës.

Ideali modernist i pastërtisë gjeometrike dhe funksionale, që u propagandua me forcë si risi në urbanistikë dhe arkitekturën e qytetit, erdhi i inspiruar dhe i ngarkuar së pari ideologjikisht, dhe në këtë kuptim strukturat e dizenuara nga planifikuesit dhe arkitektët e parë projektues modernistë u prezantuan jo thjeshtë si estetike, apo aq më pak si thjeshtë të bukura, por më shumë si sociale e internacionale, si pararendëse të qytetit universal të së ardhmes, të qytetit si simbol i shoqërisë së të barabartëve, e çliruar përfundimisht nga hierarkia klasore dhe dallimet shtresore. Përkushtimi avangardist ndaj arritjes së këtij qëllimi final, ndër të tjera kërkonte braktisjen e traditës së mëparshme urbano-arkitekture të qytetit, si pasqyruese tipike e sundimit autoritar apo si paradigma më e qartë e hierarkive irracionale monarko-fetare ndër kohëra. Modernistët stimuluan tendencën drejt shkrirjes së dallimeve të vjetra stilistikore urbane dhe arkitektonike, qofshin ato *horizontale*, pra mes komunitetesh apo zonash të ngjashme në status, por të distancuara në hapësirë apo dhe në kohë të ndryshme, apo *vertikale*, pra që lidheshin me hierarki klasore dhe shtresore brenda të njëjtit komunitet apo zonë urbane. Qasja e re në lidhje me planifikimin urban të qendrave të banuara u propozua jo aq si vazhdimësi historike ndërtimore që lidh të shkuarën urbane me të tashmen moderne, por më tepër si “*tabula rasa*”, [2] pra si një gjë e konceptuar racionalisht të nisë të ndërtohet që nga fillimi dhe në troje të reja, apo në rastin më të keq si “*urbicidi*”, [3] pra si shkatërrim i të vjetrës dhe ndërtimi mbi të i së resë. Në përvojat urbanistike të periudhës së gjysmës së parë të shekullit të XIX ndërthuren rryma të ndryshme ideologjike, siç qe *komunizmi barazitar* i Kabesë⁽¹⁾, *neokatolicizmi francez* i Bushesë apo *socializmi i krishterë* i Malkolmit⁽²⁾.

Impulsi i utopistëve për të ndërhyrë menjëherë dhe radikalisht duke eksperimentuar me raste të veçanta dhe të izoluara papritur një reformë të përgjithshme të shndërrimit të shoqërisë, reflektohet në projektimet e tyre të organizimeve ideale urbane dhe sociale, dhe bërthama e qytetit ideal fillon e hyn në kulturën urbanistike moderne si një model i karakterizuar me bazë parësore njeriun e thjeshtë, përmbushjen e nevojave të tij jetësore dhe barazitizmin e kolektivizmin mes banorëve.

Lidhja organike e argumenteve teknike urbane me ato ideologjike e politike do të vijin duke u theksuar edhe më shumë me kalimin e kohës dhe sidomos ngjarjet revolucionare të 1848 do të reflektohen më pas konkretisht në vetë filozofinë dhe praktikën urbane të qytetit të Parisit.

Prefekti i kësaj kryeqendre të madhe e të dëgjuar, baroni Haussmann, në vitet 1853-1869 ideoi konceptualisht planin e rikonstruktimit të pas-revolucionit⁽³⁾. Kultura urbanistike nuk mbetet më jashtë politikës,

1 ⁰ Cabet, Etienne. (1788-1856) - filozof francez, socialist utopist, themelues i lëvizjes kooperativiste “*Ikariane*” në Europë në vitet ’30 dhe i disa komuniteteve të tilla në SHBA në vitet ’40, autor i romanit utopist “*Voyage en Icarie*”, botuar më 1840.

2 ⁰ Malcolm, John. (1821-1911), analist dhe publicist anglez, figurë qendrore e lëvizjes “*Christian Socialism*” në vitet 1845-1854 dhe gjithashtu themeluesi i një gazete me po këtë emër.

3 ⁰ Baroni Haussmann me materializimin e rikonstruksionit të qytetit të Parisit në mesin e shekullit të XIX konsiderohet për historinë dhe teorinë e urbanistikës moderne dhe si një prej krijuesve të parë të kësaj disipline, aq i ndryshëm dhe i ri paraqitet koncepti urban që ai orientoi të projektohet nga specialistët e fushës dhe të cilin ai e konkretizoi me vull brenda një hapësire të ngushtë kohore prej 15-20 vjetësh, bashkëlidhur një kostoje tepër të lartë financiare. Me këtë plan urban ambicioz, shumëdimensional dhe të pa hasur deri atëherë, ky politikan mundësoi ndryshimin rrënjësor modernizues të qytetit mesjetar, duke ia përshtatur atë ndryshimeve të reja të erës industriale. Kështu u krijuan për herë të parë skema organizimesh racionale urbane si ajo “*yllore*” dhe “*rrezorre*”, që përfaqësonin bulevarde dhe rrugë të gjera të pa konceptuara deri atëherë në organizimin e qyteteve, të cilat dalin, fillojnë apo burojnë nga një qelizë urbane qendrore apo sheshi qendror, dhe hapen duke u shtrirë

madje anon nga thelbi i ideologjisë së re që po formohej në atë kohë në Francë, Angli dhe Gjermani, e cila i mëshonte konceptit të ndërhyrjeve rregulluese në qytetin ekzistues. *Prej këtej rrjedh pozicioni agnostik e inferior i përvojave kryesore urbanistike pas vitit 1848, pozicion pas të cilit fshihet varësia e saj politike nga e djathta e re, [4] shprehet historiani Leonardo Benevolo në librin e tij “Origjinat e Urbanistikës Moderne”. Si tezë kryesore të librit të tij, Benevolo paraqet nevojën për të analizuar dhe rigjetur në konceptet novatore të urbanistikës moderne, pikëtakimet e saj me ideologjitë dhe lëvizjet politike, të cilat gjatë fundshekullit të XIX, por sidomos gjysmës së parë të atij të XX, aspirojnë, projektojnë dhe tentojnë një transformim të përgjithshëm të shoqërisë njerëzore drejt një të ardhme sa më të lumtur të saj. Po përsëri sipas Benevolos, “...pjesa më e madhe e këtyre nismave, edhe e atyre në dukje më teknike, kanë një sfond ideologjik të mirënjohur që përputhet në një masë të madhe me fillimet e socializmit modern, aq sa për të gjetur të dhënat për këto zhvillime urbane është më e përshtatshme të konsultohesh me manualët e historisë së ekonomisë politike dhe të socializmit, sesa me librat e specializuar teknikë të disiplinës” [4].*

Diskursi modern na ka ballafaquar vazhdimisht me përmbajtjen politike dhe etike të zgjidhjeve urbane më shumë se me atë teknike. Projektme të mirënjohura teorish urbane, si ato të utopistit Robert Owen (Owen, 1771-1858), na dëshmojnë për trajtimin e urbanistikës si pjesë e ideologjisë politike, madje sipas studiuesit Benevolo, politika është e domosdoshme për të konkretizuar çdo programim urban, ndonëse nuk i nënshtrohet asnjëherë plotësisht formulave të këtyre programeve. Objektivi i kërkuar të arrihet nga utopistët e shekullit të XIX me moton “*të realizohen formulime urbane të favorshme për të gjithë, brendashkruar në një sistem që lejon pakufizim vazhdimësinë e pandërprerë të përparimit*” mbetet i vlefshëm edhe për projektimet e mëvonshme revolucionarizuese urbanistike dhe arkitektonike moderne të shekullit të XX. [4]

Edhe regjimet totalitare, si dukuri tipike të modernitetit, pavarësisht formave apo ngjyimeve ideologjike që i shpikën, i materializuan dhe në emër të së cilave ata justifikuan ligjitimitetin absolut e të pakundërshtueshëm të tyre, të gjitha papërrjashtim u paraqitën si sisteme politiko-shtetërore *revolucionarizue* në konceptin modern të këtij parimi, që do të thotë se të gjitha u përpoqën të shkëpusnin lidhjet me të kaluarën e vendit e të shoqërisë së tyre, duke iu kushtuar totalitarisht ndërtimit ndryshe të së tashmes në të gjitha fushat me aspirime për një të ardhme të lumtur kolektive.

Koncepti i “feniksit” apo “e reja lind nga hiri i së vjetrës”.

Dëshira e ethshme për të filluar gjithçka nga e para, u bë një trend global në periudhën mes dy luftërave botërore, dhe sidomos pas asaj të Dytë. Kjo qasje u lidh si me konceptin themeltar të modernitetit si teori dhe praktikë zhvillimi, po ashtu edhe me entuziazmin revolucionar të ndërtimit të *një bote të re, të drejtë dhe të barabartë për të gjithë*. Në këtë kontekst gjithëpërfshirës, edhe qyteti dhe e ardhmja e tij e re urbane u bë pjesë e kësaj ideje universale ndryshimi.

Periudha e pas Luftës së Dytë Botërore në Europë shënon një rritje të kërkesës për strehim në përgjithësi, për shkak të shkatërrimit të madh që pësoi stoku i banesave nga lufta pesëvjeçare. Tendencat e planifikimit urban të kësaj kohe janë sidomos prishjet e zonave të degraduara dhe ato informale, dhe zëvendësimi i tyre me banesa publike shumëkatëshe, me kapacitete strehimi në numër të madh banorësh.

drejtvizore, duke përshkuar racionalisht qytetin dhe u orientuar drejt periferive të tij. Po kështu sisteme rrugore progresive unazore që fillonin dhe rrezatoheshin nga qendra, bënë të mundur lidhjen ndërmjet tyre të gjithë hapësirave të qytetit. Plani haussmaniann bëri të mundur zgjerimin e rrugëve, krijimin e shesheve monumentale dhe të parqeve publik, të shpërndara racionalisht nëpër tërësinë e hapësirës urbane, pasurimin e tyre me monumente dhe vepra arti, si dhe krijimin e lagjeve të reja të banimit për standarte jetese të borgjezisë së re. Me këtë plan, i cili ruhet edhe sot, për herë të parë u ndërhy në qytet duke u rikonstruktuar dhe trajtuar ai në tërë kompleksitetin dhe totalitetin e tij, duke ndërhyrë në të gjithë elementet formues urbane si infrastruktura inxhinierike mbi dhe nëntokësore, peisazhi urban, gjelbërimi, rrugët, sheshet, kryqëzimet, lagjet, tregjet, blloqet e banimit, pallatet dhe banesat.

Lagje të tëra në Europë, por dhe në SHBA, u shkatërruan për t'u zëvendësuar me godina banimi të reja, tashmë shumëkatëshe dhe me funksione masive strehimi e shërbimesh komunitare, të projektuara nën ndikimin e lëvizjes moderniste të viteve '50 dhe më herët, të inspiruara nga ideja e *"qyteteve të së ardhmes"*, e propozuar nga arkitekti i njohur modernist, franko-zviceriani Le Corbusier që në fillimvitet '30. Ky projektues gjenial, bashkë me disa arkitektë të tjerë, që në fazën e parë të arkitekturës moderniste, propozuan zgjidhje të atilla urbanistike, të cilat do t'i përshtateshin shoqërisë të re që po ndërtohej. Pati dhe propozime ekstreme për ndërhyrje urbane deri mekanike, duke krijuar kështu një paradigmë të re të ndërhyrjeve në qytet, bazuar në konceptin e *"feniksit"*, me të cilin ilustrohej ideologjia revolucionare majtiste e kohës se *"bota e re duhej ngritur mbi gërmadhat e së vjetrës"*. Sipas këtij koncepti modern, në disa raste trashëgimia historike e qyteteve nuk u mor edhe aq parasysh, kështu që vetvetiu u anulua zhvillimi i qytetit historik dhe vazhdimësia urbane organike e tij.

Por prishjet masive dhe shkatërrimet e qyteteve njihen që herët si fenomeni *"urbicidi"* ⁽⁴⁾ dhe është një nga tendencat më regresive politike, ideologjike dhe fetare në historinë e njerëzimit⁽⁵⁾.

Politikat urbane në ndërtimin e qyteteve ku realizohen shembje masive në shkallë të gjerë dhe vijë të drejtë, për të krijuar rrugë krejtësisht të reja, njihen në disiplinën e urbanizimit dhe me emrin *"perceptions"*. Ndërhyrje të këtij karakteri urban dallohen për racionalitet dhe asimilim të qytetit historik e të trashëgimive urbano-arkitekture të mëparshme, justifikuar dhe mbështetur mbi paradigmen ideologjike që përmendëm edhe më sipër, sipas së cilës duhet shembur e vjetra për të ndërtuar të renë. Këto politika urbane ekstreme kanë ndodhur përgjatë historisë moderne botërore veçanërisht në periudha ndërrime pushtetesh me orientime ideologjike kryesisht totalitare⁽⁶⁾.

Variant i *"urbicidit"* është dhe *"çeaushima"* (emërtuar në mënyrë sarkastike si njësim i Ceaușescu + Hiroshima,) dhe ndodhi në Rumaninë socialiste të kohës kur udhëhiqte diktatori Ceaușescu, i cili vetë ai inicioi projektin e shkatërrimit të qendrës historike të Bukureshtit, për të ndërtuar më pas aty blloqe apartamentesh standarde me dendësi tepër të lartë, destinuar për banim masiv të popullsisë dhe të funksionarëve të lartë partiako-shtetëror, si dhe për instalimin aty të qindra zyrave qeveritare⁽⁷⁾.

2. Zhvillime

Në Shqipëri, fenomeni i tjetërsimeve masive urbane dhe i shkatërrimit të së vjetrës (si projektim ndërtimor modernizues) është ndeshur në periudha të ndryshme qeverisëse. Por historikisht disa nga këto ndërhyrje kanë rezultuar pozitive, profesionale dhe largpamëse, ndërsa shumë të tjera si e kundërta, më tepër si dhunë në indin urban dhe në arkitekturën e qyteteve, dhe për rrjedhojë dhe në memorien historike

4 ⁰ Termi *"urbicidi"* është përdorur nga studiuesit, arkitektët dhe planifikuesit për të nënkuptuar ato situata ku qytetet kanë qenë prejë e luftës së drejtpërdrejtë apo dhunës të ushtruar mbi to në kontekstin fizik e për pasojë edhe social, kulturor e historik.

5 ⁰ Në kulmin e zgjerimit të saj, shekujt e parë p. k., Perandoria Romake kërkoi shkatërrimin e plotë të Jeruzalemit dhe të Kartagenës.

6 ⁰ Njihet si i tillë plani revolucionar i Parisit i vitit 1793, si dhe transformimet e mëvonshme *"haussmanniane"* me ndërtimin e bulevardëve që hapen nga qendra drejt periferive në formë rrezesh. Baroni George Haussmann si prefekt i Parisit propozoi planet rregulluese në vitin 1853. (Sot, në kontrast me këtë tendencë, dizajnohet peizazhi urban i qyteteve me idenë e vazhdimësisë sociale dhe përpjekjes për t'i bërë ndërtimet sa më shumë të jetë e mundur të lidhura me të shkuarën si pjesë të vazhdimësisë historike urbane).

7 ⁰ Ndër operacionet më të mëdha totalitare ka qenë ai për ndërtimin e *"Shtëpisë së Popullit"*, sot Pallati i Parlamentit, ku për të ndërtuar këtë kompleks gjigant qeveritar u shembën masivisht banesat e shtrira në një sipërfaqe prej rreth 500 ha.

e trashëgiminë kulturore të tyre. Ajo çfarë prezantuan urbanisht qytetet (dikur historike) shqiptare në fundin e periudhës së socializmit shtetëror (në vitin 1990), do të ishte rezultati i një shumësie tensionesh natyrore, organike, historike, politike, ekonomike, demografike, shoqërore, kulturore, etj., të shtrira dhe shtresëzuara gradualisht në kohëra, por më së shumti rezultat i ndërhyrjeve të përnjëhershme mbi trupin e tyre, të ndërmarra kryesisht në disa momente të caktuara orientimesh apo ndryshimesh drastike politike.

Në historinë moderne të Shqipërisë, të tilla projekte tjetërsuese dhe të përnjëhershme në strukturën urbane të qyteteve të trashëguara u ndërmorën:

1) - gjatë periudhës mes dy luftave botërore, por duke u mundësuar të realizohen vetëm të pjesëshme dhe kryesisht në disa nga qytetet kryesore të asaj kohe;

2) - pas Luftës së Dytë, duke u materializuar në ndërhyrje ekstreme dhe të përgjithshme në shtrirje territoriale.

Në vijim të trajtesës sonë, do të ndalemi pikërisht në momentin e dytë modernizues urban, apo në periudhën e dytë historiko-politike të Shqipërisë, atë të pas Luftës së Dytë Botërore, me qëllim për të prezantuar diçka mbi modernizimin urban të qyteteve tradicionale shqiptare, referuar dhe inspiruar nga koncepte ideologjike komuniste e praktika urbane socialiste.

Në rastin e Shqipërisë së pas Luftës së Dytë Botërore, motivi frymëzues për t'i filluar gjërat nga e para më së shumti pati një pikësynim të qartë, pothuajse ekskluzivisht ideologjik: shkëputjen e lidhjeve me të kaluarën, si e papranueshme ideologjike apo si premisë për të mbajtur peng të ashtuquajturin *progres shoqëror socialist* dhe krijimin e *njeriut të ri*. Një arsye e tillë parësore, pra ajo ideologjike, mbështetet dhe nga analistë bashkëkohorë të disiplinës urbane, pasi sipas gjykimit të tyre *Shqipëria në ndryshim nga Europa perëndimore, por dhe nga vendet e tjera të Bllokut Lindor, pas çlirimit paraqiste një potencial tepër të kufizuar ekonomik për të ndërmarrë operacione tërësore sterilizimi urban të qyteteve të saja të trashëguara* [5].

Termi latin *urbicidi* është pak i njohur nga pikëpamja historiko-urbane, terminologjike apo gjuhësore në Shqipëri, por çuditërisht shumë i përdorur në trupin e qyteteve tona, sidomos gjatë periudhës së regjimit komunist [6]. Të shumta janë rastet kur vendimet për shkatërrimin e pjesëve të tëra të qyteteve tradicionale apo të objekteve të veçanta të tyre, u bënë nën moton e modernizimit socialist urban, dhe jo rrallë duke marrë vendime arbitrare, të njëanshme e joprofesionale e për më shumë me ngarkesa të theksuara politike. Këto ndërhyrje urbane (disa mjaft të diskutueshme për efektshmërinë në kohë të tyre) më shumë se ndërtimin e qytetit socialist, synonin në radhë të parë eliminimin e objekteve dhe monumenteve më përfaqësuese të trashëgimisë kulturore të shoqërisë së kaluar (kryesisht të objekteve të kultit, të kishave, të xhamive apo godinave e rezidencave qeveritare të mëparshme) dhe të infrastrukturës private të mëparshme (si të tregjeve, kafeneve, dyqaneve, vilave, rrugicave, etj.).

Shkatërrimi dhe ndërtimi u njësuat me tentativën moderne për të çrrënjësuar qytetin historik, i materializuar me vite e shekuj mbështetur mbi konceptet e gjenerimit organik dhe spontan urban, të pronës private dhe të tregtisë së lirë, si dhe mbi të drejtën e ushtrimit të besimeve fetare dhe adhurimin e ndërtesave të kultit, si shtyllat themeltare të shoqërive tradicionale. Nën parimet e modernizimit urban socialist, veçanërisht u synua të tjetërsohen qendrat e qyteteve historike, pasi aty gjendej e pranishme dhe zanafilla urbane e tyre, me tregjet tradicionale, me bujtinat e hanet, me objektet më kryesore dhe më të hershme të kultit, etj. Po kështu qendrat e qyteteve janë paraqitur historikisht edhe si fytyrat e vetë pushteteve politike ndër kohëra, me ndërtimet administrative dhe fortifikuese, me monumentet përkujtimorë, me godinat qeveritare dhe rezidencat e banimit të saj të pranishme aty, etj.

Edhe pushteti totalitar i pasluftës, po ashtu siç vepruan dhe pushtetet e tjerë përpara tij (ai i Zogut gjatë viteve 1925-1939 dhe në vijim, gjatë pushtimit të viteve 1939-1944 qeveritë e krijuara me bekimin e pushtuesve), megjithëse pati në vëmendje modernizimin urban të të gjithë vendit, përparësinë ia kushtoi

modernizimit sa më tërësor të qendrës së pushtetit, pra të Tiranës si kryeqyteti i vendit. Kështu, pas planeve urbane të kohës së mbretërisë, ku u reflektua vizioni urban dhe eksperiencia direkte e specialistëve fillimisht austriakë, e më pas e atyre italianë gjatë periudhës së pushtimit, në vitet e para të pas luftës, si kudo dhe për çdo gjë lidhur me modernizimin socialist të vendit, edhe për zhvillimin e planifikuar urban të mëtejshëm të kryeqendrës, u kërkuu ndihma e specialistëve sovietikë.

Plani urban për Tiranën i vitit 1953 u hartua nga arkitekti shqiptar Gani Strazimiri (i shkolluar në Itali para lufte dhe i diplomuar në Bashkimin Sovietik pas lufte) me bashkëpunimin e dy specialistëve sovietikë. Ky plan u materializua më së shumti me modelimin e rrugëve paralele me Lumin e Lanës, në trajektoren e tij drejt perëndimit, si dhe në plotësimin urbano-arkitekturor të pjesës së Bulevardit qendror në drejtimin e tij aksial verior. Plani i parë i pas luftës materializoi në kryeqytet konceptet e urbanistikës dhe arkitekturës staliniste, e dallur për frymën e saj eklektike neoklasike, e njohur dhe me emërtimin “*doriku i kuq*”. Prezantuese më së miri të kësaj logjike dhe stilistike janë sidomos katër blloqet e para të pallateve shtetërore shumëkatëshe të ndërtuara në Shqipëri me destinacion banimin kolektiv; pallatet *Shallvare*, pallatet *Agimi* dhe ato në vijimësi të bulevardit verior si dhe të rrugës së Durrësit. Dhe bashkë me to dhe mjaft objekte të tjera arkitektonike me destinacione qeveritare, industriale e kulturore propagandistike, si *Komiteti Qëndror i Partisë, Kombinati Stalin, Kinostudioja Shqipëria e Re, ndërtesa e Filologjikut, muzeu Lenin-Stalin*, etj.

Plani i dytë urbanistik i Tiranës u hartua në vitin 1958, nga bashkëpunimi i specialistit shqiptar Misto Mele (i shkolluar në Bashkimin Sovietik) me atë bullgar Anjgelov. Ky plan konsiderohet nga studiuesit e sotëm si plani i parë i plotë i pas çlirimit dhe ku dominon prania e specialistëve shqiptarë, por gjithnjë nën mbikqyrjen apo bashkëpunimin lindor. Plani i '58-tës për Tiranën më shumë ngjan si vazhdim i shtjellimit të logjikës dhe praktikës së planeve italiane të viteve 1939-1943, të cilat u ndjenë shumë të pranishme edhe në planin shqiptaro-sovietik të vitit 1953, dhe që vazhdojnë të artikulojnë në vijimësi në planin shqiptaro-bullgar. Por gjithashtu plani urban i '58 -tës na shfaqet edhe si një vizion i ri i modernizimit të mëtejshëm të Tiranës, por këtë herë plot tipare urbane socialiste. Ai propozon materializimin e dy zhvillimeve të reja urbane të pa hasura më parë; nga njëra anë prezanton idenë tepër të vlefshme për modernizimin e periferisë jugore të qytetit të ri, duke ideuar ndërtimin e Parkut të madh, Kopshtin Botanik dhe Zoologjik si dhe Liqenin artificial, e ndërkaq, po gjithashtu nën justifikimin apo argumentimin e modernizimit urban, po ky plan propozon edhe shkatërrimin e Pazarit të Vjetër të qendrës, duke u bërë nismëtari famëkeq i një zinxhiri prishjesh të njëpasnjëshme të kryera në vijimësi përveç pazarit edhe për pjesën tjetër të qytetit historik të Tiranës[7]. Analistët urbanë Dharmo, Thomai dhe Aliaj, në botimin e tyre “*Tirana qyteti i munguar*” përpiqen ta argumentojnë apo të zbulojnë tendencën agresive ndaj traditës që përmban më së shumti ky plan urban. Sipas tyre, meqenëse plani i '58-tës ishte një vijimësi e atyre italiane, ai mund të aprovohej nga pushteti “*lari*” vetëm duke bërë diçka të cilën planet e mëparshme, megjithëse e kishin propozuar apo e kishin hedhur si alternativë, nuk e kishin materializuar me asnjë nismë apo trajtim konkret. Mbase - hipotezojnë autorët e studimit, profesionistë të fushës së urbanistikës dhe arkitekturës, - propozimi i ndërhyrjeve me prishje të pazarit dhe në vijim të shumicës së zonës historike të trashëguar, me argumentimin se janë ansamble urbane të pa trajtuara nga planet e mëparshme dhe për rrjedhojë të degraduara nga ana urbane, arkitektonike dhe higjenike, nga hartuesit e këtij plani është përdorur si garanci ndaj sistemit zyrtar të kohës se ato nuk po respektonin planet e mëparme të hartuara në kuadrin e regjimeve ideologjike armiqsore [7]. “*Eshtë e vështirë të mendohet se autorët e planit të vitit 1958 nuk e njihnin vlerën e qytetit organik, i cili mbarte gjurmët e origjinës së vjetër të Tiranës*” - thksojnë ata - “*por një propozim i tillë i tyre kishte edhe arsye të tjera...*”. Në këtë pikë të shtjellimit të argumentave mendojmë se hyn roli dhe fuqia e madhe deformuese e dogmës socialiste dhe e vizioneve moderne urbane të dala prej saj, sipas të cilave për të ndërtuar botën e re, në këtë rast strukturën dhe trupin e ri urban të kryeqytetit, duhej shembur struktura e vjetër, që në rastin e Tiranës historike përfaqësohej nga pazari tradicional dhe lagja e tregtarëve të dikurshëm tiranas.

Imponimi apo frika në disa raste, por dhe servilizmi e devocioni militant në shumë të tjera raste, bëri

që dhe projektimi urban, si një multidisiplinë sa shkencore, historike, teknike, juridike, etj., po aq dhe poetike, psikologjike, artistike, estetike, etj., gjatë periudhës së socializmit shtetëror, të çorientohet profesionalisht dhe të orientohet më shumë ideologjikisht në vizionet e tij projektimore lidhur me modernizimin urban të qyteteve historike.

Të tilla operacione urbane, mbështetur mbi këtë logjikë dhe strategji modern-totalitare, mund të kujtojmë shumë sidomos të ushtruara në vijimësi mbi qytetin e Tiranës, ku pas Pazarit të Vjetër, i vjen rratha shkatërrimit të Kishës Ortodokse në qendër, dhe të ndërtesës së Bashkisë po në qendër. Apo ndërhyrjet prishëse-rregulluese të shtrira dhe në brendësi të lagjeve tradicionale e deri në plotësimin me tendencë deformimi të kuartalleve të “qytetit-kopësht”, të ndërtuara në Tiranën e Re sipas projekteve urbane italiane të viteve '30.

Në vend të objekteve të kultit, të ndërtesave historike dhe të komplekseve tradicionale urbane e tregtare të shembura, u ndërtua në vitet '60 “Pallati i madh i Kulturës”, në vitet '70 “Hotel Tirana”, në vitet '80 “Muzeu Historik Kombëtar”, etj. Në fillim të viteve '80 do të prishet edhe “Rruga e Dibrës”, që njihej si rruga e tregtarëve të dikurshëm tiranës, e ndërtuar në periudhën e fillimeve modernizuese, apo në vitet '20, sipas propozimeve urbane austriako-italiane. Po në këtë kohë, me kontekstin fizik të pallateve moderne shtatlarta, të destinuara për shërbime tregtare shtetërore në katet e para dhe banim kolektiv në vijimësi katesh, u ndërtuan mbi këtë truall të shtetizuar dy pallate banimi (të njohur me emrin “nënt-ëkatëshat”), të cilët u lartësuan përgjatë rrugës si propozime moderne dhe me pretendime stilistikore të fasadave, por pa u lidhur mirë me të, si dhe qëndruan armiqësorë edhe ndaj asaj pjese të lagjes së vjetër në vijimësi, që kishte mbetur ende pa u prishur [8]. Këto dy pallate (më modernet dhe më të lartat e banesave shumëfamiljare për Shqipërinë e viteve të socializmit shtetëror) u dizenuan me forma skematike *brutaliste*, stilistikë tipike për arkitekturën moderne socialiste lindore. Kjo tipologji arkitekturore në afërsi të qendrës së kryeqytetit, u prezantua mjaft moderne, por njëkohësisht dhe mjaft e huaj e deri e dhunshme, pasi nuk arriti dot të dialogonte më përreth saj, përkundrazi qëndroi tepër ftohtë ndaj kontekstit ekzistues, si të atij natyror, Malit të Dajtit, po ashtu dhe të atij urban, tradicionalitetit otoman e modernitetit eklektik me referenca stilistikore austriake e italiane të viteve '20, '30.

Po kështu ndërhyrja në strukturën morfologjike urbane të zonës “qytet-kopësht” të Tiranës së Re (e filluar të ndërtohet me një sistemim kuatall të banesave individuale të tipit vila dykatëshe rrethuar me oborre, dhe të disa godinave trekatëshe për banim kolektiv), me planet rregulluese të viteve të socializmit shtetëror, prishi raportet e dëndësisë, të hapësirave të gjelbëra dhe të lartësisë së godinave ekzistuese, duke bërë që dhe kjo situatë e trashëguar ishullore me tipare tërësisht perëndimore urbane, e vetmja plotësisht moderne në Shqipëri, dalëngadalë të transformohet në një tjetër tipologji urbane po moderne, por këtë radhë tipike socialiste, me atë të pallateve pesëkatësh për banim kolektiv, të rreshtuara në vijimësi standarte buzë rrugëve përgjatë aksit të saj gjatësor.

Synimi në vijimësi i planeve rregulluese socialiste për Tiranën, do të ishte eliminimi i çdo hapësire urbano-arkitekturore e konsideruar e huaj për pushtetin politik monist (apo larg kontrollit të tij), fshirja fizike nga thurima urbane edhe e atyre pak lidhjeve aksesuese të brendshme që ekzistonin akoma me të vjetrën, me pazarin dhe lagjen e tregtarëve e të borgjezëve të vegjël të dikurshëm të Tiranës. Ndërsa qëllimi permanent ishte dizenjimi modern socialist urban i kryeqytetit të ri, prezantimi i fytyrës së re arkitekturore të pushtetit monist sidomos në qendër e përreth saj.

Kryesisht plane urbanistike të tipologjisë ndërhyrëse prishëse-rregulluese, gjatë periudhës së viteve '45-'90, patën të gjithë qytetet më tradicionale, si Shkodra, Tirana, Korça, Elbasani, Berati, etj. Veçanërisht në qytetin e Shkodrës, mbi këtë logjikë të “zhdukjes të së vjetrës dhe afirmimit të së resë”, për 45 vjet me radhë do të projektohen dhe ekzekutohen nga shteti ndryshime dhe transformime modernizuese urbane deri në tjetërsim të identitetit historik të këtij qyteti të hershëm shqiptar. Që në vitet e para të pas luftës urdhërohet prishja e “Bexhistenit” (pazarit të vjetër të qytetit, ndër më të mëdhenjtë në Ballkan, i zonuar për shekuj buzë lumit të Bunës, poshtë kalasë së lashtë Rozafat). Po mbi këtë logjikë komuniste

revolucionare, në fundin e viteve '60, me ndalimin e ushtrimit të fesë, ekzekutohen prishje masive dhe të dhunshme të objekteve të kultit ose tjetërsime funksionalo-përmbajtësore të hapësirave të tyre. Shembet tërësisht "*Xhamia e Parrucës*", kthehet në pallat sporti "*Kisha e Madhe*", transformohen përkatësisht në kino-teatër, shkollë dhe klub rinie "*Kisha dhe Kolegji i Fretënve*", "*Kolegji Jezuit*" dhe "*Kolegji i Murgeshave*". Përfundojnë në magazina apo depo mallrash Kisha e "*Arrës së Madhe*" dhe ajo e "*Rusit*", etj. Shumica e këtyre objekteve ishin projektuar nga i famshmi arkitekt Kol Idromeno.

Në këtë valë ndryshimesh revolucionare e tjetërsimesh modernizuese që u përfshi ky qytet i hershëm, në gjysmën e dytë të viteve '60 projektohet dhe fillon ndërtimi i rrugës së re të hyrjes për në qytet. Për hapjen e saj prishen një varg ndërtimesh tradicionale të lagjes Parrucë, ndër to dhe xhamia me dy minare madhështore në qendër të kësaj lagjeje, më e hershmja e qytetit tradicional fushor. Në vend të tyre, nga të dyja anët e rrugës së re dhe tashmë të gjerë ndërtohen një varg pallatesh pesëkatëshe banimi mjaft moderne,⁸ të cilat të lidhura në vazhdimësi ndërmjet tyre mbulonin një front linear rreth 500 m përgjatë rrugës së hyrjes në Shkodër deri në truallin e ish xhamisë.

Ndërtimet e reja për banim të zbatuara përgjatë rrugëve kryesore, nxiteshin mjaft në projektimet urbanistike të atyre viteve, pasi i jepnin një pamje moderne këtyre rrugëve, por mbi të gjitha velonin me një tis socialist të përgjithshëm të gjithë qytetit. Ndërkohë që detyronin prishjen e ndërtimeve të trashëguara, ato njëkohësisht dhe mbulonin ndërtimet e tjera të vjetra të pa sistemuara që ndodheshin në brendësi të parcelave urbane ekzistuese. Më së shumti këto ndërtime të reja u projektuan pa studiuar perspektivën e zhvillimeve të mundshme urbanistike të zonave pas kësaj perdeje fshehëse arkitekturore të ngritur buzë rrugëve përgjatë gjithë intinerarit të tyre [9].

Edhe në rastin e Shkodrës, godinat e banimit përgjatë rrugës së re të hyrjes për në qytet, u projektuan sipas një studimi pjesor dhe të fokusuar vetëm në brezin gjatësor të truallit ku do të ndërhyhej, pa planifikuar perspektivën e ardhshme ndërtimore të thellësisë së kësaj zone mjaft të shtrirë urbane. Duke kërkuar troje ndërtimi, u vazhdua të ndërtohet sistematikisht në vite në brendësi të qytetit historik fushor, me ndërhyrje ekstreme urbanizuese dhe modernizuese në lagjet e vjetra me rrugica dhe banesa tradicionale, duke prishur apo copëzuar mjaft prej tyre [10]. Vetë rrugicat e ngushta e gjarpëruese, organiciteti që i kishte krijuar dhe intimiteti që ato transmetonin, ishin larg konceptit racional për kontroll dhe rregull që përbënte thelbin e hapësirës moderne totalitare. Dizenjimet e reja urbane mbi këtë qytet sjellin copëzime të oborreve dhe bahçeve të banesave "*me çardak*" të së shkuarës, duke lartësuar aty godina banimi pesëkatëshe, që sollën si pasojë fragmentarizimin mekanik urban dhe arkitekturor të këtyre lagjeve, duke miksuar në një bashkëprani krejt pa lidhje, banesa dykatëshe tradicionale dhe të distancuara nga njëra-tjetra, me këto pallate moderne socialiste, të futur artificialisht apo dhunshëm ndërmjet tyre.

Me të njëjtin koncept e logjikë, edhe në qytetin e Korçës, nën moton e modernizimit dhe të jehonës së revolucionit kulturor antifetar, me sloganin "*feja është obskurantizëm, injorancë dhe padije*", u urdhërua nga pushteti dhe u ekzekutua nga levat e tij (duke indoktrinuara dhe përfshirë në këtë rast kryesisht rininë) prishja e "*Kishës së Shën Gjergjit*" në qendër të qytetit. Në vend të saj menjëherë u projektua të ndërtohet "*Biblioteka e Korçës*", madje u arrit deri aty sa të udhëzohej të përdoreshin në ndërtimin e ri socialist edhe gurët e latuar me mjeshtëri të rrallë të kishës së shkatërruar. Kjo ndërtesë monumentale, përveç vlerave të saja arkitektonike, përbënte dhe një fakt të rrallë historik, pasi aty Fan Noli si prift kishte celebruar të parën meshë në gjuhën shqipe [11]

8 ⁰ Ky ansambël pallatesh banimi me dyqane shërbimi e tregtie në katet e para, të lidhur ndërmjet tyre me ura kalimi, u projektuan me konceptim arkitekturor mjaft modern nga arkitektët Ibrahim Prushi dhe Mauricio Bego.

Përfundime

Jo rastësisht, gjatë periudhës së ndërtimit socialist të vendit, dhuna urbane modernizuese mbi qytetet e hershme filloi nga objektet e kultit, nga banesat tradicionale, nga qendrat dhe pazaret e vjetra. Arkitektura e tyre ishte simbol i lidhjeve të ngushta botkuptimore me të kaluarën, dhe si të tilla ato duhet të zhdukeshin të parat, nga një sistem i atillë që pretendonte se po ndërtonte racionalisht nga themelet “*Botën e Re të së ardhmes së lumtur*”.

Humbja e lidhjes, braktisja e deri shkatërrimi i qytetit historik, u trajtua si një veçori e teorive dhe praktikave moderne në fushën e planifikimit urban dhe arkitektonik të viteve 1930-’50 në Europë dhe Botë. Duke u propaganduar dhe trajtuar nga etërit e lëvizjes moderniste, të përbashkuar nën institucionin ndërkombëtar të CIAM-it, këto ide e shihnin qytetin historik si infektues e pengues të vijimësisë së tij urbane dhe prandaj propozonin ndërtimin nga e para, mbi të apo larg tij. Këto ide revolucionare moderniste frymëzuan në përgjithësi urbanistikën e vendeve europiane të para dhe pas Luftës së Dytë Botërore, pavarësisht sistemeve politike të instaluar aty. Disa prej parimeve më agresive ndaj traditës urbane u formuluan dhe dolën prej CIAM-it të vitit 1933, duke u njohur me emrin “*Karta e Athinës*”, dokument në të cilin afirmohet ideja e “*qytetit modern funksional*” dhe ku së bashku me idenë themeltare, përcaktohen me statusin e “*universalitetit*” dhe 111 propozime konkrete konceptuale e teknike, të cilat në vitet ’70 do të cilësohen dhe argumentohen nga specialistët e të gjitha fushave si dokumentet më destruktive e më dogmatike të modernitetit urbano-arkitekturor, dhe që gabimisht u përkthyen për rreth tridhjetë vjet me radhë si parime universale e nuk u specifikuan, modifikuan apo u përshtatën me secilin rast konkret urban.

Autorët e “*Tirana qytet i munguar*” saktësojnë në librin e tyre se për rastin urban shqiptar mbase nuk bëhet fjalë që parimet ekstreme të lëvizjes moderne universale të CIAM-it të pranoheshin për diskutim e jo më të aplikoheshin, për shumë arsye kryesisht ideore por dhe përtej. Në kuadrin e izolimit total me perëndimin, në Shqipërinë socialiste të pas luftës (akoma tepër të varfër e të prapambetur, po ta krahasojmë me fqinjët lindorë e sidomos me ata perëndimorë) këto koncepte, skema apo tipologji urbano-arkitekturore arrijnë të depërtojnë në vend akoma më të deformatuar e të degraduar, pasi vijnë të reflektuara nga realiteti urban i disa vendeve të bllokut lindor, ku aty vetë këto koncepte ishin aplikuar me plot minuse në lidhje me origjinën e tyre.

Si konkluzion mund të themi se modernizimi i qyteteve historike shqiptare gjatë periudhës së socializmit shtetëror më shumë u projektua mbështetur dhe frymëzuar mbi inspirime ideologjike komunisto-socialiste lindore, se sa nga vetë teoritë moderne urbane, të cilat i afirmoi e i materializoi perëndimi. Pikërisht për arësye ideologjike, gjatë periudhës së ndërtimit socialist të vendit, dhuna urbane modernizuese mbi qytetet e hershme filloi nga objektet e kultit, nga banesat tradicionale, nga qendrat dhe pazaret e vjetra. Organizimi urban dhe arkitektura e tyre, duke ruajtur lidhje të ngushta botkuptimore me të kaluarën, qenë haptazi simbole të besimit fetar, të tregëtisë së lirë, të pronës private, të individualizmit dhe privacisë së jetesës. Prandaj si të tilla, ato do të zhdukeshin të parat nga skena urbane, nga sistemi i ri partiako-shtetëror i ardhur në fuqi pas Luftës së Dytë, me pretendimin se ky pushtet i ashtuquajtur “*popullor*”, po ndërtonte racionalisht nga themelet “*Botën e Re, të ardhmen e lumtur të të gjithëve*”.

Fatkeqësisht në Shqipëri, konceptet urbanistike dhe arkitekturore moderne europiane, vijnë e trajtohen në territorin shqiptar gjatë viteve 1945-1990 si kopje të deformatuar të vetë kopjeve lindore. Po kështu, shumë diferenca me konceptet dhe praktikat perëndimore, vërehen tek fryma dhe elementet shprehëse të gjuhës arkitektonike, tek materialet e përdorura dhe teknikat e ndërtimit, tek shkalla hapësinore sidomos në lartësi e godinave, etj. E përbashkëta e modernitetit socialist shqiptar, atij të bllokut lindor dhe vetë modernitetit perëndimor, duket se është vetëm motoja revolucionare *për të projektuar dhe materializuar një qytet sa më të barabartë për të gjithë banorët e tij*.

Ndërkohë që pikërisht në kulmin e konfliktit me të vjetrën deri në asgjësimin rrënjësor të saj, fenomen

që u aplikua rëndom në skenën urbane shqiptare deri në fundin e “mbretërimit” socialist nën moton e modernizimit të vendit në arkitekturën perëndimore të viteve ’60-’70 e në vazhdim, qasjet e reja postmoderne propozuan fuqishëm idenë e rikthimit të vëmendjes tek qytetet tradicionale dhe organicitetet unike urbane të tyre. Duke stimuluar kështu praninë e një kolazhi historik urban dhe arkitekturor, me kontraste mes monumentalitetit dhe intimitetit të arkitekturës tradicionale, të asaj racionaliste moderne dhe të alternative postmoderniste, gjatë çerekut të fundit të shekullit të XX, filozofia e re e arkitekturës dhe urbanistikës botërore udhëhoqi idenë e diskursit, të bashkëpranisë dhe miksimit të drejtimeve e stileve diverse urbano-arkitekture, të cilat me praninë e tyre dikotomike luajnë rol të rëndësishëm në formimin dhe pasurimin e shtresëzimeve historike urbane.

Referenca

1. Varto J., *Arti dhe mjeshhtëria e bukurisë*, sh.b. Dituria, Tiranë, 2015, f. 101.
2. Calinescu M., *Pesë fytyrat e modernitetit*, Duke University Press, sh.b. Dituria, 2012, f. 298.
3. Dhamo S., *Ndërtimi përmes shkatërrimit*, Forum A+P, nr. 8, Botimet Polis, Tiranë, 2011, f. 15
4. Benevolo L., *Origjinat e Urbanistikës Moderne*, sh.b. Dituria, Tiranë, 2011, f. 11.
5. Dhamo S., Thomai Gj., Aliaj B., *Tirana, Qyteti i Munguar*, Polis Press, Tiranë, 2016, f. 270.
6. Dhamo S., *Ndërtimi përmes shkatërrimit*, cit., f. 15.
7. Dhamo S., Thomai Gj., Aliaj B., *Tirana, Qyteti i Munguar*, Polis Press, Tiranë, 2016, f. 164.
8. Dhamo S., *Ndërtimi përmes shkatërrimit*, Forum A+P, nr. 8, Botimet Polis, Tiranë, 2011, f. 18
9. Bego M., *Skeda Arkitekture*, botim i Dea sh.p. k, Tiranë, 2004, f. 7
10. Kolevica P., *Arkitektura dhe Diktatura*, sh.b. Marin Barleti, Tiranë, 1997, f. 72.
11. Rowe C., Koetter F., *Collage City*, The MIT Press Cambridge, London, 1978.